

UDHËZIM
Nr. 99, datë 14.5.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR SHPALLJEN NË KËRKIM TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT OSE LEJES SË QËNDRIMIT, SI DHE KRITEREVE, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURËN PËR ZËVENDESIMIN E LEJES SË QËNDRIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 15, dhe të pikës 5, të nenit 144, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. PROCEDURA DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR DEKLARIMIN E HUMBJES DHE TË SHPALLJES NË KËRKIM TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT, LEJES SË QËNDRIMIT DHE LEJES UNIKE

1. I huaji ose personi i autorizuar prej tij, sapo konstaton humbjen e dokumenteve të udhëtimit dhe/ose lejes së qëndrimit/lejes unike, kryen menjëherë vetëdeklarimin, duke aplikuar *online* në shërbimin elektronik “Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme” në portalin unik qeveritar *e-Albania*, sipas formularit standard të aplikimit në aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Aplikimi aksesohet nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, ku i huaji ka vendqëndrimin.

2. Specialisti i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin në vijim “DVKM”, pasi kryen procedurën e pranimit të vetëdeklarimit, verifikon në sistemin TIMS-FER për të mësuar statusin nëse i huaji është në kërkim ose jo. Nëse të dhënat e kërkuara për këto dokumente nuk evidentohen në portalin TIMS-FER, specialisti i drejtohet strukturës përkatëse në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Departamentit për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

3. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Departamenti për Sigurinë Publike, pasi kryejnë verifikimet përkatëse, i kthejnë përgjigje autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, brenda 2 ditëve pune. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ia dërgon të huajt/personit të autorizuar, elektronikisht me vulë elektronike, vërtetimin/shkresën e pranimit.

4. Kur shtetasi i huaj ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ka nevojë të vetëdeklarojë humbjen e dokumenteve, aplikon *online*, si shtetas i huaj, në shërbimin elektronik “Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme” në portalin unik qeveritar *e-Albania*. Në rastet e deklarimit të humbjes së dokumenteve elektronike, pranohet numri i dokumentit (dhe jo numri personal i shtetasit FID).

5. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin shpall në kërkim dokumentin e humbur, sipas procedurave të miratuara për shpalljen në kërkim të dokumenteve shqiptare nga Policia e Shtetit.

6. Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin anulon dokumentin e udhëtimit, lejen e qëndrimit/lejen unike të denoncuar të humbur, duke vepruar në sistemin FER apo TIMS sipas rastit, si dhe pajis të huajin me dokument të përkohshëm ose dublikatë, duke lënë të pandryshuar numrin personal të të huajit, gjeneralitetet dhe afatin e lejes së qëndrimit/lejes unike të mëparshme.

7. I huaji ose personi i autorizuar paraqitet pranë DVKM-së për tërheqjen e dokumentit të përkohshëm apo dublikatës, vetëm pasi të jetë njoftuar nga specialisti nëpërmjet postës elektronike, apo kontaktit të vetëdeklaruar në formular.

8. Në rast se leja e qëndrimit/leja unike e shpallur në kërkim gjendet gjatë procedurës së sipërcituar, i huaji ose personi i autorizuar njoftohet për t’u paraqitur pranë DVKM-së për të tërhequr dokumentin. Nderkohë, DVKM-ja anulon dublikatin e lëshuar dhe riaktivizon vlefshmërinë e dokumentit të gjetur.

9. Nëse gjatë procedurës së kërimit gjendet dokumenti i udhëtimit, i huaji ose personi i autorizuar, njoftohet për t'u paraqitur pranë DVKM-së për të tërhequr dokumentin e gjetur dhe për të dorëzuar dokumentin e përkohshëm. Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin anulon dokumentin e përkohshëm dhe riaktivizon vlefshmërinë e dokumentit të gjetur.

II. KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR ZËVENDËSIMIN E LEJES SË QËNDRIMIT

1. I huaji, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi ose leje unike me afat 2-vjeçar dhe për të cilin afati i vlefshmërisë së lejes përfundon më shumë se një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 43/2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 79/2021, 'Për të huajt'", me kusht që të mbeten të pandryshuara rrethanat dhe kushtet mbi bazën e të cilave është dhënë leja, për qëllim zëvendësimit të saj, paraqet kërkesën përkatëse në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, drejtuar autoritetit rajonal për kufirin dhe migracionin.

2. Kërkesa për zëvendësimin e lejes së qëndrimit bëhet, nga vetë i huaji ose personi i autorizuar, duke aplikuar *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*, duke plotësuar formularin elektronik të aplikimit dhe duke ngarkuar elektronikisht dokumentet e nevojshme, si vijon:

- a) lejen aktuale të qëndrimit/unike (origjinale);
- b) fotokopje të dokumentit të udhëtimit;
- c) dokumentin që vërteton vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe kryen verifikimet në bazën e të dhënave.

4. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, pas verifikimit e pajis të huajin me një njoftim që gjenerohet nga sistemi, sipas aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, i cili përmban të dhëna për personin, lejen e qëndrimit dhe numrin personal të tij, gjithashtu, e pajis edhe me mandatpagesën për kartën biometrike të lejes së qëndrimit për të huajt, në rastet kur nevojitet.

5. Me marrjen e këtij njoftimi elektronikisht, i huaji kryen pagesën e kartës biometrike dhe brenda dy javësh njoftohet nëpërmjet postës elektronike ose kontaktit të dhënë, për t'u paraqitur pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, për të dorëzuar mandatpagesën dhe për të tërhequr kartën biometrike të lejes së qëndrimit, me vlefshmëri të lejes së njëjtë me lejen ekzistuese.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 122, datë 18.7.2024, "Për procedurën dhe autoritetet e shpalljes në kërkim të dokumentit të udhëtimit, lejes së qëndrimit dhe lejes unike, si dhe mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurën për zëvendësimin e lejes së qëndrimit", i ministrit të Brendshëm, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet, pasi të pasqyrohen zhvillimet përkatëse teknike në portalin unik qeveritar *e-Albania*.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

ANEKSI NR. 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI
SELF DECLARATION FORM

PËR HUMBJEN E DOKUMENTIT TË UDHËTIMI DHE LEJES SË
QËNDRIMIT/UNIKE
FOR LOSS OF TRAVEL DOCUMENT AND RESIDENCE/UNIQUE PERMIT

Sesioni A

Session A

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Data of the self-declarant:

FID/Numri i lejes së qëndrimit ose lejes unike/numri i dokumentit të udhëtimit

FID/Residence Permit or Unique Permit Number/Travel Document Number

--	--	--	--	--	--	--	--	--

Emër, mbiemër* <i>Name, Surname</i>	
Atësia, amësia* <i>Father's name, Mother's name</i>	
Gjinia* <i>Gender</i>	
Datëlindja* <i>Date of birth</i>	
Vendlindja* <i>Place of birth</i>	
Shtetësia* <i>Citizenship</i>	
Kombësia* <i>Nationality</i>	
Statusi civil* <i>Civil status</i>	
Arsimi* <i>Education</i>	
Aktiviteti* <i>Activity</i>	
Zgjidhni Bashkinë* <i>Choose Municipality</i>	
Adresa e saktë e të huajit* <i>Exact address of the foreigner</i>	
Dokumenti i identifikimit/udhëtimit* (një kopje bashkëngjitur formularit) <i>Identification/travel document</i> <i>(a copy attached to the form)</i>	
Numri i telefonit	

Phone number	
Email*	

* Të dhënat e shënuara me simbolin (*) janë të detyrueshme.

Sesioni B

Session B

“Regjistrim dokumenti” dhe informacionet mbi të dhëna mbi ngjarjen

“Document registration” and event data information

Përshkrimi*	
<i>Description</i>	
Data e sinjalizimit	
<i>Date of signalling</i>	

* Të dhënat e shënuara me simbolin (*) janë të detyrueshme.

Sesioni C

Session C

Me vullnetin tim të lirë:

Of my own free will:

☐ Deklaroj se kam gjeneralitetet e mësipërme dhe arsyeja që bëj këtë vetëdeklarim është se **më ka humbur**: _____ (lloji i dokumentit).

*I declare that I have the above generalities and the reason I am making this self-declaration is **the lost of**: _____ (type of document).*

Të dhënat e dokumentit të humbur*	
<i>Data of the lost document</i>	
Momenti i konstatimit*	
<i>The moment of ascertainment</i>	
Ku ka ndodhur humbja*	
<i>The place of lost</i>	

☐ Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

I declare that the data presented in this form is true.

Pas deklarimit tim dhe pasi njihem edhe me penalitetet **sipas nenit 190, të Kodit Penal**, ku: “Falsifikimi ose përdorimi i vulave, stampave apo i formularëve të falsifikuar, ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 400 000–1 000 000 lekë”, e lexoj formularin e vetëdeklarimit, e konfirmoj dhe e nënshkruaj pa vërejtje.

*After my statement and after I am also familiar with the penalties according to **Article 190, of the Criminal Code**, where: “Forgery or use of forged seals, stamps or forms, or the presentation of false circumstances in the latter addressed to state bodies, is punished with imprisonment from 6 months to 4 years and a fine from 400,000–1,000,000 ALL”, I read the self-declaration form, confirm it and sign it without any objections.*

ANEKSI NR. 2

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

NJOFTIM

Ju njoftojmë se leja e qëndrimit/leja unike për shtetasin _____, me dokument udhëtimi nr. _____, FID _____ është miratuar.

Për lëshimin e dokumentit biometrik leje qëndrimi/leje unike, ju duhet të:

Hapi 1: Kryeni pagesën për vlerën e kartës biometrike pranë Postës Shqiptare.

Hapi 2: Paraqiteni në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____, për të kryer procedurën e pajisjes me kartën biometrike leje qëndrimi/leje unike për të huajt.

Faleminderit për mirëkuptimin!

NOTE

We inform you that your Residence Permit/Single Permit for citizen _____, Travel Document no. _____, FID _____ has been approved.

To issue a biometric document Residence Permit/Unique Permit, you need:

Step 1: *Make the payment for the value of the biometric card at the Albanian Post.*

Step 2: *Be present at the Local Director for Border and Migration _____ to perform the procedure for equipment with the biometric card Residence Permit for Foreigners.*

Thank you for understanding!

Specialist i Migracionit

Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____